


NE BËJMË ZGJEDHJE TË DUHURA



DEMOKRACIA NGRIT NIVELIN E VETËBESIMIT TIM

LIRIDON (12), RAMA (12), ARTIOL (11), ARMIR (12), DELVINA (11), SAMANDA (11), VESA (12)



Demokracia më jep vlerë dhe pushtet, duke më dhënë po ashtu edhe mundësinë për të zgjedhur atë që unë dua

Të kesh besim në vete, do të thotë të besosh në aftësitë e tua për t'i arritur qëllimet e caktuara. E qëllimet nuk mund të arrihen pa liri

Demokracia është liria jonë. Ajo na jep mundësinë të udhëheqim vendin tonë, pa u ndikuar nga të tjerët. Fjala demokraci do të thotë qeverisje e popullit. Kjo automatikisht nënkupton se secili jemi përgjegjës për këtë udhëheqje të vendit tonë. Demokracia i jep fuqi secilit qytetar që të ushtrojë ndikimin e tij në shtetin

respekti, toleranca, barazia, etj. Kemi dëgjuar raste ku familjarët ua kanë ndaluar të drejtën e shkollimit fëmijëve të tyre. Kjo gjë për ne nuk është aspak e drejtë dhe njëkohësisht është edhe shkelje e ligjit. Raste të tilla po mbeten të fshehura. Andaj, ne do të mundohemi që kur dëgjojmë për këto raste t'i raportojmë tek autoritetet përkatëse. Këtë do ta bëjmë sepse e dijmë çfarë rëndësie ka demokracia.

Si shembull tjetër i shkeljes së të drejtave janë edhe rastet kur familjarët detyrojnë anëtarët e familjes të marrin vendime, që ata personalisht nuk i pëlqejnë. E ky nuk është qëllimi i demokracisë. Prandaj, të bashkuar ne mund t'i mposhtim këto shkelje të drejtash. Të bëjmë thirrje që të gjithë të zbatojmë dhe respektojmë vlerat përbërëse të demokracisë. Ashtu siç prindërit tanë janë model për ne, ashtu ne do të bëhemi model i respektimit të demokracisë dhe vlerave të saj për gjeneratat e ardhshme.




Ne populli, i japim jetë demokracisë

demokratik ku ai/ajo jeton. Kështu që, më e mira e demokracisë është që të jep mundësi të ngrisësh zërin ndaj çdo lloj padrejtësie të mundshme.


Ky sistem i qeverisjes së pari u shfaq në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Në atë kohë, në vitin 507 p.e.s. nuk ishin të drejtat e barabarta për të gjithë. Edhe në kohët e sotme kemi raste kur nga disa individë të caktuar nuk respektohen vlerat e demokracisë, si: liria,




Jemi model i qytetarëve demokratikë



Këto janë vlerat e të madhes demokraci. Falë tyre ne jetojmë në mënyrë demokratike




Kuvendi i Kosovës është institucioni më demokratik, sepse deputetët që punojnë aty zgjedhen nga ne qytetarët



Në Kuvend deputetët miratojnë ligjet. Këto ligje e sistemojnë jetën tonë



Përfaqësuesit tanë janë demokratikë. Ne i zgjedhim ata pa dallim gjinie, race, feje, apo etnie



Partitë janë të ndryshme në vendet demokratike, sepse diversiteti është pjesë e demokracisë



Sistemi më i mirë i qeverisjes sjell buzëqeshje në fytyrat tona

EDHE NE BËJMË ZGJEDHJE TË MIRA

ERJON (12), AGNESA (13), FLORESITA (12), LEONIT (12), ARSIM (12), LAURETA (12), ERLETA (12)

Në qytetin e Prishtinës, në Punëtorinë e Demokracisë së bashku me shokët dhe shoqet e klasës ne mësuam për zgjedhjet. Prandaj, vendosëm ta shkruajmë këtë artikull. Shpresojmë që do t'iu pëlqej

Fillimisht ne mësuam për dy llojet e zgjedhjeve. Ato janë: zgjedhjet komunale apo lokale dhe zgjedhjet parlamentare apo qendrore. Qytetarët e Kosovës në zgjedhjet lokale (komunale) votojnë për kryetarin/en e komunës së tyre dhe për asamblistët. Ndërsa, në Kuvendin e Kosovës punojnë 120 deputetë. Secili prej tyre punon për 4 vjet dhe zgjedhet në zgjedhjet parlamentare (qendrore).


Për të marrë pjesë në zgjedhje duhet të jemi 18 vjeçarë apo edhe më shumë. Pse kemi të drejtë të votojmë pikërisht nga kjo moshë? Sepse ne do të jemi më të pjekur dhe do të kuptojmë më mirë rëndësinë e procesit zgjedhor. Po ashtu, ne marrim informata më të shumta dhe jemi më të përgjegjshëm.

Në qoftë se të zgjedhurit tanë nuk udhëheqin mirë me shtetin, ne mund edhe të ankohe mi. Por, gjithashtu mund të mos votojmë për të njëjtin kandidat në zgje-

dhjet e ardhshme.

Në vendin tonë ne kemi obligim qytetar të votojmë. Rëndësia e votës është e madhe, pasi që një votë mund të bëj ndryshim.


Kurse, tani do të flasim se si ne zgjedhim në jetën tonë si nxënës. Ishim në orën e gjuhës shqipe, kujdestarja sapo hyri në klasë na tha se sot do të vendosim se cili do të jetë kryetari, sekretari dhe arkatari i klasës. Ajo kërkoi nga ne që të marrim nga një fletë të bardhë dhe aty të shkruajmë emrin e njërit prej tre kandidatëve. Ata ishin: Armiri, Erjoni dhe Rama. Pasi votuam u pa se Erjoni kishte marrë 20 vota, Rama 10, kurse Armiri 5. Arsyeja pse ne votuam për Erjonin më shumë ishte sepse Erjoni është nxënës shumë i sjellshëm dhe ka të gjitha notat e shkëlqyeshme. Kjo do të thotë se edhe ne kemi shumë mundësi për zgjedhje, edhe pse jemi akoma fëmijë. Faleminderit për leximin tuaj.



Kutia më e fuqishme e botës, kutia e votimit



Gazetarët më të mirë në vend



Shpresoj që një ditë edhe unë të punoj këtu



Kjo jam unë duke menduar për zgjedhjet

VULLNETI YNË NUK KA TË NDALUR

ELTON (12), ARBNOR (12), SUELA (12), ALTINA (11), SARA (11), QUNI (12)



Këtu kemi paraqitur shkollën tonë, roli i së cilës është shumë i madh në jetën tonë. Pranë shkollës kemi vizatuar një nxënës i cili është duke mbledhur mbeturinat rreth shkollës. Kemi paraqitur vetëm një, por zakonisht në këto lloje të aktiviteteve jemi të përfshirë të gjithë nxënësit e shkollës

Me qytetari aktive nuk kuptohet vetëm pjesëmarrja në zgjedhje. Por, janë një mori gjërash që na bëjnë aktiv

Qytetaria aktive shpeshherë mendohet të jetë element kyç për një shoqëri demokratike. Ajo çka e bën të veçantë qytetarinë aktive është vullneti i qytetarëve që të bëjnë ndryshime pozitive në vendin ku ata jetojnë, që ndryshe ne e njohim si komunitet. Iniciativat mund të jenë të ndryshme. Si për shembull, disa qytetarë



Të gjelbëruar dhe të pastër, qytetarët aktiv e duan vendin e tyre

mund të bashkohen për të pastruar ambientin, ashtu siç e bëjmë edhe ne shumë shpesh. Një herë në vit mbledhemi të gjithë nxënësit e shkollës dhe bëjmë pastrimin e ambientit shkollor. Kurse, ne nxënësit e klasës sonë këtë gjë e bëjmë çdo të dytën javë. Puna të cilën ne si nxënës e bëjmë ka vlerë të madhe, sepse në një mënyrë apo tjetrën ne po mësohemi që

roli ynë, ani pse si nxënës, është shumë i rëndësishëm për vendin tonë. Përveç kësaj, ne nuk mendojmë vetëm për njerëzit, por po ashtu edhe për kafshët. Në orën e lëndës së ekologjisë kemi bërë disa shtëpi të vogla për zogj. Në këtë mënyrë gjatë kohës së dimrit këta zogj do të kenë një fole të tyre dhe nuk do të rrezikojnë të ngordhin nga të ftohtit. Pa dyshim, nga kjo kanë përfituar më së shumti zogjtë. Por, gjithashtu përfitues jemi edhe ne, për arsye se e kemi mësuar se sa e rëndësishme është të bësh punë në mënyrë tërësisht vullnetare. Këto që i cekëm janë vetëm disa nga rastet e shumta që ne jemi treguar qytetarë aktiv dhe vullnetarë.

Ne jemi aktiv, por kjo nuk është e mjaftueshme për shoqërinë tonë. Ne kemi nevojë për më shumë zëra aktiv. Andaj, bashkohuni këtij rrugëtimi që ne kohë më parë iu kemi bashkuar. Ne iu mirëpresim krahëhapur!



Aktiv në ide, aktiv në veprime



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Rexhep Kadrijaj“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Rastavicë, Deqan